




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



PROJEKTVENDIM

Nr.3, datë 04.07.2022

PËR

**KORRIGJIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.10/2 PROT., DATË 03.05.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN
NR.5, DATË 25.04.2017 “PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE, SUBJEKTIT
“ALBPLAST”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes nr.10/2 prot., datë 03.05.2017 miratuar me vendimin nr.5, datë 25.04.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Pusi-1

Nga: X= 501521; Y= 4550442; Z= 90.5 m.m.n.d

Në : X= 501493; Y= 4550408; Z= 85 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.003 \text{ m}^3/\text{s}$

Pusi-2

Nga: $X= 549413$; $Y= 4551016$; $Z= 90.1 \text{ m.m.n.d}$

Në : $X= 501576$; $Y= 4550428$; $Z= 85 \text{ m.m.n.d}$

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.003 \text{ m}^3/\text{s}$

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes n nr.10/2 prot., datë 03.05.2017 miratuar me vendimin nr.5, datë 25.04.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për “Përdorim burimi uJOR nëntokësor për qëllime teknologjike”.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

